



Në mbështetje të nenit 19 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 85/2010), nenit 17 pika e) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008) dhe nenit 5 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 569/1 të datës 16.12.2010, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e vet të mbajtur më 29 shkurt 2016, miratoi këtë:

V E N D I M

PËR MBROJTJEN E VLERËS SË NATYRËS TRUNGU I SHPARDHIT (*Quercus frainetto*) NË DRENOC TË RAHOVECIT SI MONUMENT I NATYRËS

Neni 1

Me këtë vendim merret nën mbrojtje vlera e natyrës Trungu i shpardhit (*Quercus frainetto*) në fshatin Drenoc të Rahovecit si monument i natyrës i karakterit botanik (këtu e tutje: Monumenti i Natyrës).

Monumenti i Natyrës me hapësirën përfshirëse të projeksionit të kurorës dhe zonës buferike prej 10 m. rreth projeksionit të kurorës, përfshinë sipërfaqen prej 4 ari.

Monumenti i Natyrës ka pamje karakteristike të kurorës, vjetërsi dhe vlera të tjera natyrore dhe si i tillë është i rrallë jo vetëm për territorin e Komunës së Rahovecit.

Lartësia e kërcellit të Monumentit të Natyrës është rreth 37 m, perimetri i kërcellit është rreth 3.80m, diametri i kurorës rreth 1.40 m dhe vjetërsia është mbi 350 vite.

Neni 2

Monumenti i Natyrës gjendet në parcelën 1142-0, zona kadastrale Drenoc, nr. P-71510026-01142-0, me sipërfaqe 1403 m², e regjistruar si rrugë e pakategorizuar në pronësi të P.SH. e KOSOVES Kuvendi Komunal Rahovec.

Neni 3

Monumenti i Natyrës sipas IUCN - it kategorizohet si vlerë e natyrës e kategorisë së III – të, Natural Monument / Natural Landmark – Monument i Natyrës.

Neni 4

Për Monumentin e Natyrës përcaktohet regjimi mbrojtës i shkallës së III-të, të mbrojtjes në të cilën përcaktohen masat dhe kushtet vijuese me të cilat:

Në Monumentin e Natyrës ndalohet:

- a) Prerja e trungut, thyerja e degëve, mbledhja e gjetheve apo fryteve, kositja e barit si dhe çfarëdo veprimtarie e cila ndryshon gjendjen e tanishme,
- b) Ndezja e zjarrit në sipërfaqen e mbrojtur,
- c) Mbjellja e bimëve me qëllim të gjelbërimit të sipërfaqes së mbrojtur,
- d) Ndryshimi i pamjes së sipërfaqen së mbrojtur,
- e) Grumbullimi i mbeturinave në sipërfaqen e mbrojtur,
- f) Punimi (lëvrimi, shfrytëzimi) i tokës në sipërfaqen e mbrojtur dhe
- g) Aktivitetet të tjera të cilat mund të shkaktojnë ndryshime ose dëmtime të Monumentit të Natyrës.

Në Monumentin e Natyrës lejohen:

- a) Të gjitha masat e mbrojtjes biologjike-teknike të Monumentit të Natyrës nën kushtet të cilat i përcakton Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe në bazë të Projektit për sanimin e gjendjes së Monumentit të Natyrës si dhe punët teknike të cilat janë në funksion të mbrojtjes të Monumentit të Natyrës.

Neni 5

Në zonën buferike të Monumentit të Natyrës ndalohet:

- a) Lëshimi i ujërave të ndotura, deponimi i mbeturinave dhe mbetjeve të tjera,
- b) Përdorimi i mjeteve mbrojtëse kimike,
- c) Ndërrimi i kulturës,
- d) Mbjella e bimëve ose ngritja e objekteve të cilat mundën me ndikuar në pengimin e pamjes të Monumentit të natyrës.

Zona buferike e Monumentit të Natyrës si dhe hapësira rrethuese mund të rregullohet dhe të shfrytëzohet për qëllime të prezantimit me kusht që destinimet e reja nuk e rrezikojnë Monumentin e Natyrës.

Neni 6

Për zbatimin e masave dhe kushteve të përcaktuara, kujdeset Komuna e Rahovecit.

Kujdestari është i detyruar:

- a) Monumentin e Natyrës ta mbroj, ta ruaj dhe mirëmbajë në pajtim me kushtet e përcaktuara të mbrojtjes,
- b) Në rast të paraqitjes të ndryshimeve të cilat Monumentin e Natyrës mundën ta shkatërrojnë ose t'i dëmtojnë vetitë e rëndësishme të tij, menjëherë të lajmëroj Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës,
- c) Të bëjë shënjimin e kufijve të Monumentit të Natyrës në pajtim me Rregulloren për Shënjimin e Zonave të Mbrojtura.

Neni 7

Planet hapësinore dhe urbanistike, projektet, bazat ekonomiko-pyjore, hidroekonomike duhet të harmonizohen me masat dhe kushtet për mbrojtjen e Monumentit të Natyrës.

Neni 8

Ky Vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe pas vlerësimit të ligjshmërisë të aktit nga autoritetit mbikëqyrës i Ministrisë së Pushtetit Lokal, në kuptim të Nenit 81 të Ligjit për qeverisje Lokale Nr.03/l- 040.

01 Nr. 556
Rahovec, 29.02.2016

Kryesuesi i Kuvendit
Nahit Elshani

